

V E N D I M
Nr.303, datë 1.7.1999

PËR KRIJIMIN E SISTEMIT TË AKREDITIMIT NË ARSIMIN E LARTË

(Ndryshuar me VKM nr. 611, datë 4.12.2002)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 13 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Sistemi i akreditimit ka për funksion drejtimin dhe kryerjen e procesit të akreditimit në shkollat e larta. Institucionet e sistemit të akreditimit të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë janë Këshilli i Akreditimit dhe Agjencia e Akreditimit, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

2. *Këshilli i Akreditimit është organ kolegjial. Anëtarët e këtij këshilli emërohen nga Ministri i Arsimit dhe i Shkencës, i cili miraton edhe statutin e këtij këshilli.*

Këshilli përbëhet nga 9 veta, personalitete (akademikë, me tituj shkencorë e me përvojë), në fushën e arsimit të lartë, shkencës dhe të ekonomisë shqiptare.

Kryetari i Këshillit të Akreditimit emërohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës. Ai shpërblehet çdo muaj me 20 për qind të rrogës së profesorit, kurse anëtarët me 15 për qind të rrogës së profesorit.

3. Agjencia e akreditimit është institucion publik, buxhetor, në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Numri i punonjësve të kësaj agjencie është brenda numrit të punonjësve të planifikuar për vitin 1999, për sistemin e arsimit dhe të shkencës dhe buxheti i saj për vitin 1999 mbulohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe shkencës. Për kryerjen e funksioneve Agjencia angazhon edhe punonjës të jashtëm.

Agjencia e Akreditimit i ka zyrat në mjediset e Qendrës së Informacionit dhe të Dokumentacionit Shkencor dhe Teknik.

4. Trajtimi financiar i drejtorit të Agjencisë së Akreditimit barazohet me klasën B4 të lidhjes nr.1 "Renditja e funksioneve sipas klasifikimit", ndërsa specialistëve me klazën IX të lidhjes II,M "Pagë bazë sipas klasave për punonjësit e ministrive, institucioneve të tjera qendrore, RTV-së, ATSH-së dhe prefekturave".

5. Këshilli i Akreditimit miraton kriteret e vlerësimit të brendshëm, programor dhe institucional, të hartuara nga Agjencia e Akreditimit, miraton kërkesën e shkollës së lartë për vlerësimin përkatës, si dhe periudhën gjatë së cilës duhet të kryhet ky vlerësim, vendos për rezultatin përfundimtar të vlerësimit, sipas raportit të hartuar nga Agjencia e Akreditimit. Rezultati përfundimtar quhet pozitiv, kur plotësohen kriteret e caktuara. Në të kundërt quhet negativ. Këtë rezultat këshilli ia paraqet për vendim Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

6. Agjencia e Akreditimit harton kriteret e vlerësimit të programeve dhe të institucioneve, të cilat ia paraqet për miratim Këshillit të Akreditimit dhe ua bën të njohura të gjitha shkollave të larta. Kjo agjenci regjistron kërkesat e shkollave të larta për vlerësim institucional. Ajo, gjithashtu, kryen vlerësimin e programeve dhe vlerësimin institucional. Rezultatet e vlerësimit ia paraqet Këshillit të Akreditimit.

7. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, pas shqyrtimit të raportit të dhënë nga Këshilli i Akreditimit, nëse ai është negativ, merr vendimin për mbylljen ose jo të kurseve ekzistuese të studimit ose paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave mbylljen ose jo të shkollave ekzistuese të larta publike apo të strukturave të tyre përbërëse. Studentëve të këtyre kurseve

apo shkollave u krijohet mundësia për vazhdimin e kursit të ngjashëm në një shkollë tjetër të lartë në rast se është e mundur një e tillë. Kur nuk gjenden mundësi që studentët ekzistues të përfundojnë studimet, këto kurse lejohen të funksionojnë vetëm vitet që kanë mbetur për të përfunduar ciklin.

Në rastin e arimit të lartë jopublik, në qoftë se raporti i Këshillit të Akreditimit është negativ, kjo ministri merr vendim për mosnjohjen e kurseve ekzistuese të studimit ose i propozon Këshillit të Ministrave mosnjohjen e shkollës.

Këto procedura janë të vlefshme edhe për kurset e studimit në shkollat pasuniversitare.

Në rastin e vlerësimeve pozitive, Ministri i Arsimit dhe Shkencës shpall nivelin e diplomës.

8. Procedura e vlerësimit kryhet kur vetë shkolla kërkon të vlerësohet ose kur këtë gjë e kërkon Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

9. Një degë apo shkollë e lartë publike mund të funksionojë pa u akredituar për një periudhë jo më shumë se 4 vjet. Në rast se shkolla nuk e kërkon vlerësimin brenda kësaj periudhe, Ministria e Arsimit dhe Shkencës duhet t'ia kërkojë këtë vlerësim Agjencisë dhe Këshillit të Akreditimit.

10. Shkollat e larta jopublike marrin përsipër të gjitha shpenzimet financiare për vlerësimin dhe akreditimin e tyre, në përputhje me aktet nënligjore përkatëse.

11. Agjencisë së Akreditimit, që nga dita e krijimit në përputhje me këtë vendim, i jepet një afat kohor 6-mujor për hartimin e kriterëve të vlerësimit të shkollave të larta.

12. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko